

UDHËZIM
Nr.23, datë 12.11.2007

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR.1, DATË 8.1.2007 “PËR
PROCEDURAT E PRIVATIZIMIT ME ANKAND TË PAKETAVE SHTETËRORE TË
AKSIONEVE TË SHOQËRIVE TREGTARE QË VEPROJNË NË SEKTORËT
JOSTRATEGJIKË”**

Në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.119, datë 18.3.2000 “Për procedurat e privatizimit me ankand të paketave shtetërore të aksioneve në shoqëritë tregtare që veprojnë në sektorët jostrategjikë”, i ndryshuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.119, datë 27.2.2003 dhe me vendim të Këshillit të Ministrave nr.776, datë 11.10.2006, Ministri i Financave dhe Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës,

UDHËZOJNË:

1. Paragrafi IV i pikës 2, germa A, kapitulli II, ndryshohet, si më poshtë vijon;

Vendosja e afisheve të publikimit pranë shoqërive që privatizohen, si dhe në mjediset publike të vendndodhjes së subjektit, të bëhet nga degët e shoqërive publike në prefekturë, sipas të dhënave të dërguara nga Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike në Ministrinë e Financave. Degët e shoqërive publike në prefekturë, brenda afateve të publikimit, dërgojnë zyrtarisht procesverbalin e vendosjes së afisheve në Drejtorinë e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike.

2. Pika 2 e germës “B” kapitulli II ndryshon, si më poshtë vijon:

Brenda 30 ditëve nga data e publikimit të radhës, punonjësit e shoqërisë bëjnë regjistrimin e kërkesave për zotërim aksionesh në këmbim të bonove të privatizimit në Drejtorinë e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike, në bazë të përcaktimeve të pikave 1, 2, 3 të shkronjës B të këtij vendimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI E FINANCAVE
Ridvan Bode

MINISTRI I EKONOMISË, TREGTISË
dhe energjetikës
Genc Ruli